

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6547  
E martë, 1 mars 2022  
çmimi 0.40 €

Organizatat joqeveritare:  
Të miratohet Projektligji  
për Financimin e  
Subjekteve Politike | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PESË DITË PAS PUSHTIMIT RUS, PALËT NISIN BISEDIMET | FAQE 4-5

## UKRAINA KËRKON ARMËPUSHIM TË MENJËHERSHËM DHE TËRHEQJEN E FORCAVE RUSE



Në ditën e pestë të pushtimit rus të Ukrainës, delegacionet e dy vendeve kanë nisur bisedimet në Bjellorusi, me qëllim të dhënies fund luftës. Zyra e presidentit ukrainas ka njoftuar se dëshirojnë armëpushim të menjëhershëm dhe tërheqjen e forcave ruse. Ndërkaq, Moska, sipas negociatorit rus Vladimir Medinsky, dëshiron të arrijë një marrëveshje që është në interes të të dyja palëve

### AKTUALE



KUVENDI MBLIDHET MË 5 MARS  
PËR NDER TË EPOJESË SË UÇK-SË | F. 7

MTS I LARGON NGA TRANSMETIMI  
KANALET RUSE NË KOSOVË | F. 6

KONJUFCA NDERON TË RËNËT E  
LIKOSHANIT DHE TË ÇIREZIT | F. 6

### EKONOMI



BERZH-I, ROL TË RËNDËSISHËM  
PËR NJË TRANZICION TË DREJTË  
ENERGJETIK NË KOSOVË | F. 8

RUBLA RUSE ZHVLERËSOHET NË  
NIVEL REKORD | F. 8

### SPORT



GIRESE: ËSHTË E QARTË  
SE NË KOSOVË TË GJITHË  
PRESIN REZULTATE | F. 10

## Bislimi: Sanksionet e vendosura do ta dobësojnë fuqishëm qeverinë e Moskës | FAQE 5



SHKRUAN: PROF. IBRAHIM GASHI

## A PO RRËSHQET BOTA NË NJË 'LUFTË TË RE TË FTOHTË' | FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

Pesë ditë pas pushtimit rus, palët nisin bisedimet

# Ukraina kërkon armëpushim të menjëhershëm dhe tërheqjen e forcave ruse

Në ditën e pestë të pushtimit rus të Ukrainës, delegacionet e dy vendeve kanë nisur bisedimet në Bjellorusi, që synojnë t'i japin fund luftës. Zyra e presidentit ukrainas ka njoftuar se dëshirojnë armëpushim të menjëhershëm dhe tërheqjen e forcave ruse. Ndërkaq, Moska, sipas negociatorit rus Vladimir Medinsky, dëshiron të arrijë një marrëveshje që është në interes të të dyja palëve

**KIEV, 28 SHKURT (ER)** - Ukraina është në ditën e pestë të luftës pasi presidenti rus Vladimir Putin urdhëroi sulmin ndaj vendit fqinj. Të hënën janë zhvilluar disa runde të bisedimeve në Bjellorusi mes delegacionit të Rosisë dhe atij të Ukrainës.

Ukraina ka kërkuar një armëpushim të menjëhershëm dhe tërheqjen e forcave ruse. Ndërkaq, Moska, sipas negociatorit rus, Vladimir Medinsky, dëshiron të arrijë një marrëveshje që është në interes të të dyja palëve.

Negociatat në mtë es Ukrainës dhe Rosisë filluan në kufirin Ukrainë - Bjellorusi. Zyra e presidentit Zelensky ka njoftuar se në delegacionin ukrainas merr pjesë ministri i Mbrojtjes Oleksii Reznikov dhe këshilltari presidencial Mikhaïlo Podoliak. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka kërkuar anëtarësim të shpejtë në BE në një video-mesazh përmes të cilit ai u bëri thirrje trupave ruse t'i dorëzojnë armët. "Qëllimi ynë është të jemi së bashku me të gjithë evropianët dhe më e rëndësishmja, të jemi në një pozitë të barabartë. Jam i sigurt se është e drejtë. Jam i sigurt se është e mundur", ka thënë ai.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se kishte pasur një telefonatë me udhëheqësin ukrainas dhe se "e vlerësoi atë për guximin e popullit dhe forcave të armatosura të Ukrainës". "Aleatët e NATO-s po rrisin mbështetjen me raketa mbrojtjeje ajrore, armë antitank, si dhe ndihmë humanitare dhe financiare", ka shkruar Stoltenberg në "Twitter".

Rusia u përball me presion të shtuar diplomatik dhe ekonomik të hënën, ditën e pestë të fillimit të agresionit ndaj Ukrainës.

Ministria britanike e Mbrojtjes ka njoftuar të hënën se trupat ruse vazhdonin të ishin mbi 30 kilometra në veri të kryeqytetit të Ukrainës, Kiev, duke shtuar se "dështimet logjistike dhe rezistenca e fortë ukrainase vazhdojnë ta pengojnë përparimin rus".

Ky vlerësim përputhet me vlerësimin e një zyrtari të lartë amerikan të mbrojtjes, i cili u tha gazetarëve të dielën, se "nuk kemi asnjë tregues se ushtria ruse ka marrë kontrollin e ndonjë qyteti". Bombardimet e fundit të qytetit të Kharkivit kanë lënë të vdekur një grua dhe janë plagosur 31 persona. Të plagosur janë 15



ushtarë dhe 16 civilë, sipas Këshillit të qytetit që ka lëshuar deklaratë për shtyp. Gjatë ditëve të fundit Këshilli i qytetit ka regjistruar 44 të plagosur, përfshirë 20 ushtarakë dhe gjithsej shtatë të vrarë. Shtatë viktimat përfshijnë dy ushtarë dhe pesë civilë.

Ukraina i përket Bashkimit Evropian dhe blloku do të donte ta shihte atë si pjesë të tij, tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, për televizionin "Euronews". "Në të vërtetë, me kalimin e kohës, ata na përkasin neve. Ata janë një prej nesh dhe ne i duam ata", ka thënë von der Leyen.

Komentet pasojnë një votim historik të 27 vendeve të BE-së për furnizimin me armë të Ukrainës. Ukraina është nën pushtimin e plotë të forcave ruse qysh më 24 shkurt.

Shteti rus kundërshton integrimin e saj në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

## Ukrainasit kthehen në atdhe për të luftuar

Përderisa qindra mijëra refugjatë po ikin nga Ukraina, pas sulmit rus ndaj vendit të tyre, disa burra dhe gra ukrainase po kthehen në vendin e tyre nga shtete të ndryshme evropiane, për të ndihmuar në mbrojtjen e atdheut të tyre. Nja 22 000 njerëz kanë hyrë në Ukrainë që nga e enjtja, kur Rusia e ka pushtuar atë, ka bërë me dije Roja Kufitare e Polonisë.

## Protestat kundër luftës përhapen në mbi 50 qytete ruse

Nga Shën Pjetërburgu deri në Siberi rusët po vazhdojnë ta shprehin kundërshtimin ndaj pushtimit ushtarak të Ukrainës nga ana e vendit të tyre, teksa protestat kundër luftës janë përhapur në më shumë se 50 qytete të Rosisë. Policia ka shtypur protestat më 27 shkurt, duke arrestuar më shumë se 2 700

persona, sipas grupit për të drejta.

## Finlandezët dhe suedezët janë pro anëtarësimin të Ukrainës në NATO

Pushtimi i Putinit në Ukrainë po ndryshon rrënjësisht pikëpamjet evropiane, pasi një sondazh i publikuar nga televizioni finlandez "YLE" ka zbuluar se shumica e popullsisë së vendit është në favor të anëtarësimin në NATO, dhe kjo ndodh për herë të parë në histori. Sipas sondazhit të kryer javën e kaluar, me një kampion përfaqësuesish prej rreth 1 400 personash, 53 për qind e finlandezëve tani mbështesin pranimin e Finlandës në NATO, me 28 për qind kundër dhe 19 për qind të pasigurt. Pushtimi i Rosisë ka rritur mbështetjen për anëtarësimin në NATO në Suedi, me një sondazh të porositur javën e kaluar nga transmetuesi publik suedez SVT që tregoi 41 për qind për dhe 35 për qind kundër.



## Kosova dhe Mali i Zi diskutojnë për bashkëpunim në digjitalizimin e shërbimeve komunale

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHKURT - Bashkëpunimi në nivelin lokal ndërkufitar, digjitalizimi i shërbimeve komunale dhe projektet e përbashkëta ndërshtetërore në fushën e zhvillimit lokal ishin temat kryesore të cilat u diskutuan në takimin zyrtar në mes të ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi dhe ministres për Administratë Publike, Shoqëri Digjitale dhe Media e cila mbulon edhe Pushtetin Lokal në Malin e Zi, Tamara Srzentiq. Krasniqi i ka uruar mirëseardhje në Kosovë ministres Srzentiq, duke e falënderuar për bashkëpunimin korrekt dhe marrëdhëniet e mira në mes të dy shteteve. Ai ka thënë se synojnë

thellimin e këtij bashkëpunimi në projektet dhe prioritetet ndërshtetërore.

Gjatë këtij takimi ministri Krasniqi e informoi ministren Srzentiq për projektet strategjike dhe programet zhvillimore të MAPL-së, të cilat përfshijnë përmirësimin e agjendës legislative të nivelit lokal, zhvillimin infrastrukturor dhe kapital të komunave, digjitalizimin dhe transparencën për ofrimin e shërbimeve komunale më efikase për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, ministria e Malit të Zi, Tamara Srzentiq, ka falënderuar ministrin Krasniqi për pritjen dhe gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në nivelin lokal duke u fokusuar te bashkëpunimi ndërkufitar, digjitalizimi dhe transparenca. Ajo e njoftoi ministrin Krasniqi për disa nga programet dhe iniciativat



kryesore të Malit të Zi në fushën e zhvillimit të nivelit lokal, duke theksuar reformën në administratën

publike, transformimin digjital dhe ofrimin e shërbimeve më efikase të bazuara në e-qeverisje. Në fund të takimit ministri Krasniqi dhe

ministria e Malit të Zi janë pajtuar për thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët ndërshtetëror.

## Organizatave joqeveritare: Të miratohet Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Democracy Plus, KDI, D4D, Lëvizja FOL dhe organizata Çohu kanë shprehur keqardhjen për dështimin e shqyrtimit dhe miratimit në parim të Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike gjatë seancës plenare të mbajtur më 22 shkurt. "Cilësia dhe ushtrimi i demokracisë është i pandashëm nga roli dhe funksionet që luajnë partitë politike. Në këtë mjedis rëndësia mbi rregullat dhe parimet për mundësi dhe burime të barabarta financiare, shpërndarje dhe shpenzime transparente janë thelbësore për vlerat dhe përkushtimin e



partive dhe institucioneve në angazhimin për një shtet të lirë nga korrupsioni", është thënë në letrën e këtyre organizatave joqeveritare drejtuar anëtarëve të

kryesisë së Kuvendit dhe shëfave të grupeve parlamentare. Më tej është thënë se duke ditur rëndësinë që ky projektligj ka për promovimin e transparencës

financiare si parakusht i qeverisjes së mirë kanë kërkuar që i njëjti të shqyrtohet në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit që u mbajt të hënën, në mënyrë që të vendoset si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës.

Këto organizata joqeveritare kanë theksuar në letrën e tyre se shëfat e grupeve parlamentare duhet të arrijnë pajtim brenda grupeve parlamentare që të ketë pjesëmarrje të të gjithë deputetëve në procesin e votimit. "Ne mirëkuptojmë qëndrimet e ndryshme që mund të kenë subjektet politike lidhur me projektligjin si tërësi apo

pjesë të caktuara të tij, megjithatë kërkojmë që këto qëndrime të shprehen dhe të përkthehen në kontribut gjatë shqyrtimit të projektligjit në mes të dy leximeve. Zvarritja e mëtutjeshme e shqyrtimit dhe miratimit të këtij projektligji, i cili është obligim në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane (ERA) si dhe është në përputhje me rekomandimet e shoqërisë civile dhe opinionin e Komisionit të Venedikut, është e paarsyeshme dhe dëmton integritetin e subjekteve politike dhe besueshmërinë e publikut ndaj tyre", është thënë në letrën e këtyre organizatave joqeveritare.

## Tahiri: Partitë politike duhet të bëhen bashkë për një strategji të re për sigurinë në vend

EPOKA  
ERE

Q. RAMA

PRISHTINË, 28 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka bërë me dije, në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të hënën, se ka kërkuar debat parlamentar për sigurinë në vend. Ai ka thënë se situata që shihet në luftën në Ukrainë, tentimi dhe sulmi i drejtpërdrejtë i Rusisë mbi tërësinë territoriale dhe sovranitetin e një shteti demokratik dhe reshtimin e Kosovës përkrah

botës perëndimore, përkrah qytetarëve të Ukrainës, është një moment i cili duhet të reflektojmë. "Rrethanat të cilat janë krijuar në aspektin e sigurisë, si në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe në nivel të Ballkanit Perëndimor, kërkojnë po ashtu, një reflektim edhe të parlamentit të Kosovës. Si AAK kemi adresuar disa çështje me rëndësi: një ka të bëjë me strategjinë e re të sigurisë kombëtare të vendit, që ndërlidhet edhe me veprimet më të shpejta në anëtarësim të Kosovës në NATO. E dyta ka të

bëjë me fondin për forcimin e financimit të ushtrisë sonë, që ka qenë një kërkesë e kamotshme e jona, që lidhet drejtpërdrejt me rishikimin e buxhetit për siguri", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se në qoftë se një botë demokratike u bashkua në ndihmesë të një kauze të drejtë të shtetit dhe qytetarëve të Ukrainës, pse mos të bashkohemi edhe ne si subjekte politike, për një kauzë të drejtë, për një strategji të re në raport me sigurinë në vend, por edhe për pozicionin e Kosovës në këtë temë.





SHKRUAN: PROF. IBRAHIM GASHI

# A po rrëshqet bota në një 'luftë të re të ftohtë'

Agresioni i hapur i Federatës Ruse mbi shtetin e pavarur të Ukrainës dhe pozicionimet e qarta të një pjese të botës demokratike përballë situatës së re të krijuar kanë rritur shqetësimet mbi rikthimin e një rendi botëror të dominuar nga kërcënim, pasiguria dhe nga një paqe e brishtë dhe e rrezikuar në çdo çast.

Që në vitet e para të këtij shekulli tensionet për paqen dhe sigurinë botërore, që shpresohet se morën fund me mbarimin e Luftës së Ftohtë, filluan të rishfaqen njëra pas tjetrës. Terrorizmi që u mendua se do të jetë forma e luftërave të reja dhe kërcënim i vetëm për vendet demokratike dhe të zhvilluara të botës, shpejt u pasua me luftime ndërmjet forcave autoritare dhe atyre reformatore si dhe shumë fraksioneve të brendshme sektare në vendet e Lindjes së Mesme, e njohur si "pranvera arabe". Në vitin 2008 u rikthyen edhe invadimet ushtarake dhe ndërhyrjet e në sovranitetin dhe integritetin territorial të një shteti më të fortë ndaj një shteti më të dobët. Promotore e kësaj forme klasike të luftës ishte pikërisht Federata Ruse dhe udhëheqësi i saj autoritar Vladimir Putin, kur dha urdhrin

për ndërhyrje ushtarake kundër shtetit të Gjeorgjisë (2008), duke i shkëputur atij dy krahina të banuara me përqindje më të madhe ruse, (Osetinë Jugore dhe Abkhazinë) dhe duke i njohur ato njëanshëm si shtetet të pavarura.

Federata Ruse do ta vazhdojë politikën e saj agresive edhe ndaj ish-republikave të tjera të BRSS-së, para së gjithash ndaj Ukrainës, si një nga shtetet më të mëdha që nuk ishte përfshirë në strukturat evropiane dhe euroatlantike, por që një pjesë e popullsisë dhe e lidhshimit të saj po e manifestonte një afiliencë të tillë. Duke pasur parasysh rëndësinë e Ukrainës, si nga aspekti ekonomik, po ashtu edhe nga pozita e saj gjeostrategjike, Kremlinin filloi ta paralajmëronte Kievin se nuk e dëshironte një Ukrainë në NATO as në BE, madje as një Ukrainë të pavarur dhe neutrale, por një Ukrainë ruse. Për të arritur këtë synim në politikën e tij të jashtme agresive lideri më autoritar i kohës sonë, Vladimir Putin, duke ndjekur skenarin e Gjeorgjisë, vendosi ta godiste Ukrainën në pikën më neuralgjike, por edhe më të dobët të saj, në atë të gadishullit të Krimesë. Në fakt, fati i

Krimesë, por edhe i gjithë Ukrainës, siç e kemi parë, ishte i lidhur me preferencat e ndryshme të dy rrymave kryesore politike në vend, njëres pro perëndimore dhe tjetrës pro ruse. Pasojë e drejtpërdrejtë e politikës pro ruse të presidentit Yanukovich, i cili i fitoi zgjedhjet presidenciale të vitit 2010, është kriza e Krimesë, e cila filloi në nëntor të vitit 1913, në një kohë kur presidenti Yanukovich abrogoi marrëveshjen e asociimit me BE-në dhe forcoi lidhjet me Moskën zyrtare. Një pjesë e ukrainasve filluan protestat në rrugë me kërkesë forcimin e lidhjeve me Evropën. Kësaj edhe një herë po testohej disponimi dual i ukrainasve. Një pjesë e tyre me përkatësi etnike ruse ose me afiliencë politike pro ruse mbështetnin presidentin Yanukovich, derisa pjesa tjetër me afiliencë politike pro evropiane mbështetnin opozitën e udhëhequr dhe kërkonin lirinë e ish-kryeministres Yulia Timoschenko të cilën regjimi i Yanukovichit e kishte hedhur në burg me akuzën për korrupsion. Situata eskaloj. Protestat e opozitës morën përmasa të mëdha gjatë dimrit 2013/2014. Ndërhyrja e autoriteteve ishte

brutale. Rrugët e Kievit u mbushën me protestues dhe barrkada. Me urdhrin e presidentit prorus u përdorën armët dhe ranë viktimat e para. Demonstruesit antiqeveritarë zunë ndërtesa në qendër të Kievit, përfshirë ndërtesën e Ministrisë së Drejtësisë. Trazirat lanë 98 të vdekur, rreth pesëmbëdhjetë mijë të plagosur dhe 100 konsiderohen të zhdukur. Autoriteti i presidentit Yanukovich filloi të lëkundej. Por largimi i tij nuk shënoi triumfin e opozitës. Në situatën shumë të ndërë të krijuar në gadishullin e Krimesë, i cili dominohej numerikisht nga banorët me përkatësi ruse, shpërthyen trazirat dhe rebelimi qytetar. Qytetarët rusë të Krimesë filluan ta sfidojnë rendin kushtetues duke i bërë thirrje Kremlinin zyrtar për ndërhyrje. Ky i fundit në mënyrë shumë të koordinuar, duke shfrytëzuar praninë e madhe ushtarake në gadishull (një pjesë e flotës ruse ishte e stacionuar në ujërat e Krimesë për arsye strategjike, sipas marrëveshjes për pavarësinë e Ukrainës të vitit 1990). Më 18 mars 2014 Rusia dhe Krimea nënshkruan një traktat të aderimit të Republikës së Krimesë dhe Sevastopol-it në

Federatën Ruse, edhe pse Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara votoi në favor të një deklarate jodetyruese për ta kundërshtuar aneksimin rus të gadishullit.

Epilogu i tillë i Krizës së Krimesë shërbeu si uverturë multiplikuese e këtij skenari edhe në pjesët e tjera të Ukrainës, veçmas të Ukrainës Lindore të dominuar nga popullata me përkatësi etnike ruse. Në disa qytete në rajonet Donetsk dhe Lugansk, burra të armatosur, që e deklarojnë veten e tyre si milicia lokale, kishin konfiskuar ndërtesat qeveritare dhe stacionet e policisë. Bisedimet në Gjenevë mes BE-së, Rosisë, Ukrainës dhe Shteteve të Bashkuara rezultuan me një deklaratë të përbashkët diplomatike të referuar si Pakti i Gjenevës 2014, me të cilën kërkohej nga grupet e jashtëligjshme paramilitare të hiqnin dorë nga armët, të lironin ndërtesat qeveritare dhe t'i ktheheshin një dialogu politik që do të çonte në më shumë autonomi për rajonet e rebeluar. Bisedimet e Gjenevës nuk sollën pothuaj asnjë efekt të pritur. Zgjedhja e presidentit të ri ukrainas Poroshenko (i cili nuk njihet nga ekstremistët rusë,

# Bislimi: Sanksionet e vendosura do ta dobësojnë fuqishëm qeverinë e Moskës

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, së bashku me ministrin e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një konferencë të përbashkët për medie kanë folur rreth zhvillimeve të fundit nga situata e krijuar pas invazionit rus në Ukrainë si dhe për rastin e arrestimit të tre shtetasve serbë nga Policia e Kosovës.

Ky konflikt, tha zëvendëskryeministri Bislimi, na tregoi se sa i rëndësishëm është krijimi i një fronti të përbashkët mes të gjitha demokracive për të pamundësuar që iniciativat e tilla ushtarake të finalizohen me sukses. "Sanksionet e vendosura nga BE-ja, ShBA-ja dhe vendet e tjera, e të cilave u është bashkëngjitur menjëherë edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, besojmë se do ta dobësojnë fuqishëm Qeverinë e Moskës dhe

ndikojnë në tërheqjen e tyre nga planet për Ukrainën", ka vlerësuar zëvendëskryeministri Bislimi. Ndërsa ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, duke folur rreth një rasti konkret të arrestimit nga Policia e Kosovës të tre shtetasve serbë të cilëve u ishin gjetur pesë emblema të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tha se, sipas informacioneve nga institucionet e sigurisë, personat e dyshuar kanë hyrë nga Serbia në Kosovë në po të njëjtën ditë, pra të shtunën; kanë tërhequr shumica të konsiderueshme të parave dhe më tutje kanë shkuar për të blerë veshmbathje ushtarake në një nga dyqanet në Prishtinë. Ministrja Haxhiu lirim të këtyre personave e ka vlerësuar si hap të çuditshëm, duke thënë se "fakti që personat në fjalë nuk janë mbajtur as 48 orë në Stacion Policor, tregon mospërfilljen ndaj cenimeve të mundshme të sovranitetit dhe integritetit territorial".



rrjedhimisht as nga vetë Rusia) dhe veçmas deklarata e tij në mbremjen e zgjedhjeve të datës 25 maj 2014 se "udhëtimi im i parë presidencial do të jetë për në Donbas dhe se "operacioni anti-terrorist i forcave qeveritare nuk do të zgjasë dy-tre muaj, por vetëm disa orë" shërbeu si impuls i ri për kryengritësit rusë, të cilët tashmë kishin shpallur autonominë e krahinave Donetsk dhe Lugansk. Në këso rrethanash Poroshenko iu drejtua Moskës për bisedime me ndërmjetësimin ndërkombëtar, kërkesë që u hodh poshtë nga Kremli zyrtar, me arsyetimin se Rusia nuk do të bisedojë asnjëherë për Ukrainën me ndërmjetës ndërkombëtarë. Nga ana tjetër, presidenti Poroshenko ka deklaruar se sovraniteti i Ukrainës do të ruhet, madje duke premtuar se ka për të ndjekur deri në fund kthimin e Krimesë nën sovranitetin e Ukrainës.

Fundi i vitit 2021 dhe veçmas muajt e parë të këtij viti shpërfaqen planet agresive që Putini kishte ndaj shtetit fqinj të Ukrainës. Tani në kulmin e dimrit në kufirin ruso-ukrainas, Kremli dërgoi rreth 150 000 trupa në një stërvitje ushtarake që mund të cilësohet si kërcënimi më i hapur dhe i drejtpërdrejtë ndaj territorit të Ukrainës. Trajektorja e zhvillimeve nga gjysma e muajt shkurt filloi të dinamizohet. Sipas një plani mirë të përgatitur nga Putini dhe aparati i tij

ushtarak, nxiten popullsinë e dy regjioneve të banuara me shumicë ruse, Lugansk dhe Donetsk, që të shpallin pavarësinë nga Kiev. Sigurisht që ky skenar i Putinit tashmë lexohej lehtë. Siç edhe pritej, Moskë nxitoi që ta njohë sovranitetin e shpallur të këtyre regjioneve dhe për të qenë ironia e plotë e kësaj loje, Putini deklaroi që atje do të nisë një kontingjent ushtarak "paqeruajtës: për të mbrojtur këto dy entitete të vetëshpallura si sovranë. Ky skenar, në fakt, përbente "pretekstin" e Putinit për ta filluar agresionin ushtarak total mbi gjithë Ukrainën, me destinacion nënshtrimin e Kievit dhe kapjen ose vrasjen e kreut politik të pabindur, presidentit V. Zelenskit.

Tani kur nga data 24 shkurt, dita e fillimit të agresionit rus, edhe në ditën e pestë, Ukraina nuk po dorëzohet, përballë një stuhie të paparë sulmesh raketore dhe artilerike ruse në të gjitha qytetet e mëdha pa zgjedhur fare caqet, në skenë ka dalë një heroizëm i paparë njerëzor i popullit dhe udhëheqjes atdhedashëse ukrainase në krye me presidentin Zelenski, duke ngjallur admirimin dhe simpatinë më të madhe të botës liridashëse anekënd globit. Këto akte të rezistencës heroike të popullit të Ukrainës kanë bërë që vendet e fuqishme të Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të ndihen keq për injorimin që i kanë bërë seriozitetit të situatës duke

reaguar fillimisht në mënyrë fare indolente dhe të fragmentarizuar.

Tani, në ditën e katërt, kur rezistenca dhe lufta dhëmbë për dhëmbë në mbrojtje të Kievit por, mbi të gjitha, fushata e sulmeve raketore, artilerike dhe ajrore ruse, kryesisht mbi caqe civile, duke lënë qindra civil të vrarë, si dhe një valë e madhe e refugjatëve ukrainas që po largohen në drejtim të vendeve fqinje, si duket kanë prekur ndërgjegjen dhe sigurinë e vendeve demokratike të BE-së dhe të NATO-s. Reagimet e fundit të Shtëpisë së Bardhë, të NATO-s dhe të BE-së janë në një sintoni të plotë dhe në përmbajtjen e tyre janë masat e duhura sa i takon ashpërsisë së tyre, por sigurisht relative sa iu përket efekteve të shpejta që do të mund të prodhojnë. Si përgjigje ndaj këtyre masave, dhe veçmas vendimit të vendeve të BE-së për ta furnizuar Ukrainën, (si shtet nën sulm), me armë dhe masa e largimit të Federatës Ruse nga sistemi i SWIFT-it, Putini ka dhënë urdhër ngritjen e shkallës më të lartë të alarmit dhe të gatishmërisë së armatimit bërthamor.

Në këtë situatë të re të krijuar shtrihet pashmangshëm pyetja kah po ecën rendi botëror? Një gjë tashme mund të pohohet me saktësi se agresioni ushtarak i Putinit në Ukrainë ka shënuar një ndryshim tektonik në politikën botërore dhe ka rritur rrezikun e konfrontimit të superfuqive dhe

militarizimit të Evropës. Po ashtu, nëse i referohemi deklaratës së presidentit francez E. Macron, se "bota duhet të përgatitet për një luftë të gjatë midis Rusisë dhe Ukrainës pasi Moskë filloi një pushtim të fqinjëve të saj properëndimor", apo deklaratës së djeshme të kongresistit demokrat nga Kalifornia Ro Khana sipas të cilit, "...Ukraina mund të përfundojë si Afganistani i Rusisë. Kjo me të vërtetë i lëndoi ata në Luftën e Ftohtë. Në planin afatgjatë, kjo do të jetë shumë e kushtueshme për Putinin, kështu që unë jam për sanksione dhe jam i hapur ndaj asaj që propozon administrata për atë që ne duhet të bëjmë për t'i ndihmuar ukrainasit nga perspektiva e mbrojtjes". Edhe vendimi i djeshëm i kancelarit gjerman, në një seancë të jashtëzakonshme, të parën të mbajtur ditën e diel, për rritjen e buxhetit për ngritje të kapaciteteve ushtarake në 100 miliardë euro dhe fjalimi i tij para Bundestagut, ku Scholz e përshkroi sulmin rus në Ukrainë si një "pikë kthese" që kërkonte një përpjekje kombëtare gjermane për ta ruajtur rendin politik dhe të sigurisë në Evropë. Në këtë linjë duhet parë edhe vendimin e djeshëm të BE-së që, siç thuhet, "për herë të parë ndonjëherë, Bashkimi Evropian do ta financojë blerjen dhe dërgimin e armëve dhe pajisjeve të tjera në një vend që është nën sulm". Deklarata e kryeministrit britanik B. Johnson, dhënë me rastin e fillimit të agresionit rus

në Ukrainë, "jam i tmerruar nga ngjarjet e tmerrshme në Ukrainë dhe kam folur me presidentin Zelenskiy për të diskutuar hapat e ardhshëm. Presidenti Putin ka zgjedhur një rrugë gjakderdhjeje dhe shkatërimi duke nisur këtë sulm të paprovokuar ndaj Ukrainës. Mbretëria e Bashkuar dhe aleatët tanë do të përgjigjen me vendosmëri."

Këto reagime të Perëndimit të dhëna brenda katër ditëve të para nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë dhe masat sanksionuese që po pasojnë këto deklarata, veçmas ato ekonomike, po e shprien rendin botëror drejt një konfrontimi të ri, të një shtrirjeje dhe shkalle shumë të madhe, çfarë nuk e kemi parë që nga Lufta e Ftohtë. Është akoma herët të konstatojmë se bota po rrëshqet drejt një lufte të re të ftohtë, por sigurisht se kjo mund të diskutohet në nivel të analizës. Herët sepse ende nuk kemi parë pozicionim të pjesës tjetër të botës, përkatësisht fuqive të mëdha aziatike si Kina. Indiferenca e saj në këtë tensionim të ri nuk do të jetë e gjatë. Konsideroj se efektet që mund të ketë largimi i Rusisë nga SWIFT dhe ngrirja e aseteve të saj në botë do t'i godisnin drejtpërdrejt marrëdhëniet tregtare të Rusisë me Kinën dhe kjo do ta shtyjë Kinën ta qartësojë qëndrimin e saj. Pamja mbi të ardhmen e rendit botëror mund të qartësohet më shumë, varësisht nga rrjedha dhe epilogu që mund të ketë lufta në Ukrainë.

## Konjufca nderon të rënë e Likoshanit dhe Çirezit

SKENDERAJ, 28 SHKURT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka bërë homazhe në fshatrat Likoshan dhe Çirez, për t'i nderuar 24 martirët e vrarë në këto dy fshatra 24 vjet më parë. Me këtë rast kryetari Konjufca ka thënë se 28 shkurti i vitit 1998 shënon edhe datën kur filloi gjenocidi në Kosovë. "Pra kjo është dita kur fillojnë masakrat gjithandej në vendin tonë prej ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë, të gjitha të urdhëruara, të komanduara e të vendosura në sistemin shtetëror serb, të udhëhequr nga hierarkia shtetërore institucionale e shtetit serb", ka deklaruar Konjufca.

Duke pasur parasysh këto, kryetari i Kuvendit ka theksuar se Serbia si shtet është përgjegjëse për të gjitha ato masakra që ka kryer mbi popullatën e pafajshme civile të Kosovës. Konjufca ka thënë se institucionet do t'i kujtojnë dhe nderojnë gjithmonë martirët dhe dëshmorët e Kosovës që ranë për lirinë e vendit. "Kjo ditë e shënuar dhe shumë të tjera si kjo na kujtojnë gjithmonë çmimin e lartë që populli ynë e pagoi për lirinë dhe pavarësinë e Republikës. Po ashtu, edhe obligimin tonë institucional që të sjellim drejtësi për të gjitha viktimat e gjenocidit serb", ka thënë Konjufca.



## Zëvendëspresidenti i Parlamentit Evropian viziton Drenasin



DRENAS, 28 SHKURT (ER) - Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland. "Vizita e zëvendëspresidentit të Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, në Drenas, çdoherë është e mirëpritur, sepse sjell perspektivë, energji të reja dhe motiv për ta ngritur performancën, angazhimin dhe bashkëpunimin në dobi të qytetarëve dhe komunës sonë", ka thënë Lladrovci. Ai ka theksuar se me Wieland "Qytetar nderi" i komunës së Drenasit dhe bashkëpunëtorët e

tij kanë pasur diskutim të përbashkët edhe me disa drejtorë të drejtorive të komunës duke u fokusuar në qeverisjen e mirë, arsimin, zhvillimin ekonomik, kulturën dhe çështjet me interes të përbashkët. "Në takim ishte i pranishëm edhe konsulli i deritashëm në Shtuttgart, Imer Lladrovci, me të cilin e kemi shoqëruar Wielandin edhe në takimet me kryetarët e disa komunave të tjera, sipas agjendës së tij. Jemi të bekuar me miqësinë e Wielandit dhe Gjermanisë", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".

## Klinika e Kardiologjisë dhe ajo e Nefrologjisë kërkojnë avancim të shërbimeve shëndetësore

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Në vazhdim të vizitave në klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, kryesuesja e Bordit Drejtues të ShSKUK-së, Agreta Gashi, bashkë me anëtarët e Bordit dhe drejtorin e përgjithshëm, Valbon Krasniqi, kanë vizituar të hënën Klinikën e Kardiologjisë dhe atë të Nefrologjisë në QKUK. Gjatë takimit me drejtorët e këtyre klinikave dhe stafin shëndetësor është biseduar për punën, sfidat dhe kërkesat që kanë këto klinikat. Drejtuesit e klinikave kanë

njoftuar lidhur me punën që është bërë dhe po bëhet nga klinikat, me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore. Gjatë takimit u paraqiten nevojat dhe kërkesat që kanë këto klinikat për avancim të shërbimeve shëndetësore. Bordi Drejtues dhe menaxhmenti i ShSKUK-së ofruan përkrahje dhe bashkëpunim për këto klinikat, bazuar në mundësitë buxhetore dhe planin e punës të paraparë për investime gjatë vitit 2022.



## Krasniqi në Likoshan dhe Çirez: Kosova është përplot vepra heronjsh



SKENDERAJ, 28 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në 24-vjetorin e masakrës së Likoshanit dhe të Çirezit, ka bërë homazhe në kompleksin e varrezave të

këtyre fshatrave. Krasniqi është shprehur se Kosova është përplot me vepra heronjsh, prej atyre që dhanë gjithçka dhe të gjitha për atdheun. "24 vjet më parë ishin banorët e Likoshanit dhe të Çirezit që i

dolën përballë armikut pushtues, duke mbrojtur shtëpitë dhe nderin me jetët e tyre. Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të Kosovës që u bënë dritë në rrugën e çlirimit!", ka thënë Krasniqi.

## Kuvendi mbledhet më 5 mars për nder të Epopesë së UÇK-së

**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 SHKURT - Kuvendi i Kosovës do të mbledhet të enjten, më 3 mars, në orën 10:00, në seancë të rregullt plenare, ndërkaq të shtunën, më 5 mars, në orën 12:00, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të mbajë seancë solemne. Kështu vendosi të hënën Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve parlamentare, të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca.

Pas shterimit të pikave të zakonshme, deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, në seancën e së enjtes Kuvendi do ta shqyrtojë në lexim të dytë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administrimin e



Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 14/62, datë 23.02.2022, për

vazhdimin e masave emergjente në furnizimin e energjisë.

Në këtë seancë, po ashtu, pritet të formohet Komisioni

Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidateve për një anëtar të Bordit për Ankesa të Medieve, si dhe ai për përzgjedhjen e kandidatëve

për dy anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare.

## MTS i largon nga transmetimi kanalet ruse në Kosovë



PRISHTINË, 28 SHKURT - Kryeshefi i Komisionit të Pavarur për Medie në Kosovë (KPM), Faruk Rexhaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shumica e operatorëve shpërndarës, apo operatorëve kabllovikë, i kanë larguar nga

transmetimi kanalet e Federatës Ruse. "Jemi njoftuar se shumica e operatorëve i kanë larguar këto kanalet. Ne sot i kemi monitoruesit në terren. Do të verifikohen operatorët e shpërndarjes që veprojnë në

Kosovë, se a e kanë respektuar vendimin e KPM-së apo jo", ka deklaruar Rexhaj.

Komisioni i Pavarur i Medieve i Kosovës ka vendosur më 26 shkurt për largimin e përkohshëm nga transmetimi i

të gjitha kanaleve me origjinë nga Federata Ruse, me qëllim të, siç është thënë, parandalimit të propagandës dhe mbrojtjes së sigurisë publike në Kosovë.

Vendimi është marrë dy ditë pasi Rusia ka nisur pushtimin e plotë të Ukrainës.

Në mesin e këtyre kanaleve janë: RT, Russia 24 dhe Planeta RTR.

Faruk Rexhaj i KPM-së thotë se këto kanalet janë transmetuar nga operatori i shpërndarjes MTS, i cili funksionon në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

MTS është nën pronësi të Telekomit Serb dhe është themeluar në vitin 2015 në bazë të një marrëveshjeje midis Kosovës dhe Serbisë, të arritur në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. REL konfirmon edhe përmes disa personave privatë, të cilët jetojnë në komunat me shumicë serbe në Kosovë, se kanalet ruse janë larguar nga MTS-i. Sipas Rexhajit, ka qenë edhe një operator shqiptar që ka

transmetuar kanalet ruse. "Ka pasur edhe operator shqiptar të shpërndarjes që ka bërë transmetimin e këtyre kanaleve. Telkos ka pasur dy kanale ruse, mirëpo të njëjtat i ka larguar qysh para vendimit të KPM-së", ka thënë Rexhaj.

Nëse vendimi i KPM-së nuk respektohet, Rexhaj tha se do të ketë dënime për operatorët deri te pezullimi i licencës.

Komisioni i Pavarur i Medieve është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës.

KPM-ja licencon transmetuesit publikë e privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit, si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbime mediale, audio dhe audiovizuale.

Një ditë më herët Bashkimi Evropian ka vendosur t'i ndalojë mediet ruse në BE, siç janë: RT dhe Sputnik, si dhe filialet e tyre.

## Komisioni për Legjislacion miraton në parim dy projektligje

PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të kryesuar nga Adnan Rustemi, kryetar.

Në këtë mbledhje, pas diskutimeve, janë miratuar në parim Projektligji për pronën publike dhe Projektligji për kompensimin e viktimave të

krimin të cilat do të procedohen për miratim në seancë plenare.

Po në këtë mbledhje janë formuar grupet punuese për shqyrtimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; për shqyrtimin e Projektligjit për Tokën Ndërtimore; për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të

Personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës; Ligjit nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, si dhe Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë. Më pas anëtarët e këtij komisioni janë pajtuar që në kuadër të planit të punës për vitin 2022, konkretisht në sesionin vjeshtor, ta fusin edhe nismën për hartimin e Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.



# BERZh-i, rol të rëndësishëm për një tranzicion të drejtë energjetik në Kosovë

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

LONDËR, 28 SHKURT - I shoqëruar nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, Ilir Kapiti, kryeministri Albin Kurti takimin e parë bilateral në kuadër të pjesëmarrjes në Samitin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) e zhvilloi me drejtoreshën menaxhuese të BERZh-it për Infrastrukturë të Qëndrueshme, Nandida Parshad dhe drejtorin menaxhues për Ekonomi të Gjelbër dhe Klimë në Harry Boyd Carpenter. Kryeministri Kurti ka thënë se është kënaqësi që po takohet në selinë qendrore të BERZh-it në Londër, duke falënderuar për ftesën dhe mirëpritjen. Ndër temat qendrore të takimit ishin mjedisi dhe energjia. Kryeministri Kurti ka folur për

kapacitetet aktuale të prodhimit të energjisë në vend dhe teknologjinë e vjetër të termocentraleve si dhe për përvojën e Kosovës në përballimin e krizën globale të energjisë. Ai ka theksuar synimin dhe nevojën e vendit për diversifikim të energjisë elektrike, me vëmendje të veçantë te burimet e ripërtërishme. Kurti ka theksuar se në këtë drejtim Qeveria e Kosovës është duke punuar në hartimin e Strategjisë së Energjisë e cila, përpos dekarbonizimit, do të synojë ta ruajë sigurinë e furnizimit me energji dhe përbalueshmërinë për konsumatorë duke rritur përdorimin e energjisë së pastër. Ndërkaq, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka folur për rëndësinë e eficiencës së energjisë elektrike dhe projektet aktuale që po gjejnë zbatim. Ai ka shtuar se BERZh-i ka një rol të rëndësishëm në



qëllimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për një tranzicion të drejtë energjetik. Nandita Parshad, në anën tjetër, ka shprehur mbështetje ndaj synimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për

dekarbonizim dhe energji të pastër. Ajo ka theksuar se BERZh-i është e gatshme ta ndihmojë Kosovën për synimin e saj për një tranzicion të drejtë energjetik. Në takim, gjithashtu, u

diskutuan mundësitë e tjera dhe format e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BERZh-it. I pranishëm në këtë takim ishte edhe përfaqësuesi i BERZh-it për Kosovë, Neil Taylor.

## Rubla ruse zhvlerësohet në nivel rekord



MOSKË, 28 SHKURT - Monedha kombëtare ruse ra në nivel rekord, pasi G7, apo grupi i vendeve më të industrializuara, vendosi sanksione të ashpra financiare kundër Rusisë për shkak të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës. Rubla ra të hënën në 114 kundërt dollarit amerikan, krahasuar me 83.7 në fund të javës së kaluar. Rubla ka humbur rreth 40 për qind të vlerës së saj që nga fundi i tetorit kur Rusia ka nisur të grumbullojë trupa në kufi me Ukrainën. Në fundjavë G7 ka bërë me dije se do ta sanksionojë Bankën Qendrore të Rusisë dhe do t'i përjashtojë disa nga institucionet e saj më të

mëdha financiare nga sistemi global bankar, i njohur si SWIFT. Sanksionet e pengojnë aftësinë e Bankës Qendrore për ta mbrojtur rublën duke i shitur rezervat e saj në monedhat e G7-s. Njoftimi për sanksione ka ngjallur frikë te rusët, të cilët janë parë në radhë të gjata në fundjavë, duke pritur për të tërhequr para dhe për t'i shkëmbyer rublat. Rezervat e Rusisë kanë arritur në më shumë se 600 miliardë dollarë në shkurt. Banka Qendrore thuhet se ka shpenzuar rreth 5 miliardë dollarë të rezervave të saj për ta mbrojtur monedhën më 24 shkurt, në ditën kur Rusia ka pushtuar Ukrainën.

## Nga 1 marsi do të rriten sërish çmimet e produkteve të bulmetit në Shqipëri

TIRANË, 28 SHKURT - Shtrenjtimi i çmimeve të produkteve të bulmetit në Shqipëri do të ndikohet nga shtimi i kostos së çmimeve më të larta të naftës, energjisë, plastikës dhe heqjes të skemës të TVSH-së të kreditueshme 6 për qind që nisi zbatimin nga 1 janari 2022. Për shkak të rritjes së kostos nga këto faktorë, përfaqësuesi i kompanisë "Lufra", Luis Ndreka ka thënë për

"Monitor" se tashmë kompania ka lajmëruar që nga 1 marsi çmimet do të rriten 10 për qind. "Ne kemi bërë një lajmërim në fillim të muajit shkurt që do të rrisim çmimet në fillimin e muajit mars, sepse kemi kontrata të cilat duhet t'i respektojmë. Çmimet do të rriten me rreth 10 për qind, sepse kostot janë rritur shumë. Çmimi për lëndën e parë është rritur mjaft, duke

rritur koston e qumështit të prodhuar nga fermerët. Po ashtu janë rritur shumë kostot e lëndëve plastike në tregun botëror, çka është reflektuar në Shqipëri. Po ashtu çmimi i energjisë elektrike po ndikon direkt te kostot, pasi në industrinë tonë kërkohet përdorim i lartë i energjisë elektrike. Po ashtu edhe çmimi i naftës na ka ndikuar shumë".





# A do të zgjerohet lufta e Putinit?



Nga Jacob HEILBRUNN  
"National Interest"

Në vitin 1946, Walter Bedell Smith, ambasadori i sapoemëruar i Britanisë në Bashkimin Sovjetik, u largua në orët e vona nga selia e ambasadës për t'u takuar me Josif Stalinin në Kremlin. Winston Churchill, sapo kishte mbajtur fjalimin e tij të famshëm mbi "Perden e Hekurt", dhe marrëdhëniet midis Perëndimit dhe Lindjes ishin shumë të ftohta.

Lufta e Ftohtë kishte nisur tashmë. Pyetja e parë që i bëri Smith udhëheqësit sovjetik ishte: "Çfarë kërkon Bashkimi Sovjetik, dhe sa larg do të shkojë Rusia?". Stalini ishte i ftohtë. "Ai nuk më pa në asnjë rast drejt e në sy" - shkroi Smith në kujtimet e tij "por e mbajti kokën të kthyer në anën tjetër, duke thithur herë pas here duhanin në lullën e tij". Pasi Smith ia përsëriti pyetjen, Stalini e shikoi më në fund në sy dhe i tha: "Ne nuk do të shkojmë shumë larg".

Por sa larg do të shkojë lufta e presidentit rus Vladimir Putin në Ukrainë? A do të përpiqet ai të

nënshtrijë jo vetëm Ukrainën Lindore, por edhe atë perëndimore? A do të përpiqet të krijojë një urë tokësore për në Kaliningrad përmes Lituanisë, duke u përballur me përballjen e drejtpërdrejtë me NATO-n?

Duke sulmuar Ukrainën Putini është përfshirë në lojën më të guximshme të karrierës së tij. Edhe pse është përshkruar shpesh si një udhëheqës i kujdesshëm dhe oportunist, pushtimi i Ukrainës përgënjeshtroi pretendimin zyrtar të Kremlinit se Rusia nuk kishte ndërmend të sulmonte dhe se Perëndimi po bëhej "histerik" me akuzat mbi këtë çështje.

Në fakt, vetë gjuha e Putinit të mërkurën të kujtonte kërcënimet e dikurshme të Nikita Khrushchev me luftën bërthamore: "Kushdo që përpiqet të ndërhyjë në operacionin tonë, dhe aq më tepër të krijojë kërcënime për vendin dhe popullin tonë, duhet ta dijë se përgjigja e Rosisë do të jetë e menjëhershme, dhe do t'ju shkaktojë pasoja të tilla që nuk i keni përjetuar kurrë në historinë tuaj".

Ndoshta synimi përfundimtar i Putin është të krijojë në Ukrainë

një shtet-kukull, duke aneksuar një pjesë të madhe të këtij vendi. Në këtë drejtim, synimi i tij do të ishte ta dërrmojë me shpejtësi ushtrinë ukrainase dhe të zhdrukë sa më shumë që të jetë e mundur, çdo manifestim të krenarisë kulturore dhe kombëtare të Ukrainës.

Po ashtu ai do të tentojë të eliminojë elitat ukrainase, ashtu siç bëri Bashkimi Sovjetik në bllokun lindor pas Luftës së Dytë Botërore. Flitet se ai dëshiron të rivendosë në pushtet Viktor Yanukovich, ish-presidentin e korruptuar të Ukrainës, që u rrëzua pas protestave popullore të vitit 2014.

Qeveria aktuale e Ukrainës, e udhëhequr nga presidenti Volodymyr Zelensky, ka të ngjarë të kërkojë një vend për të funksionuar si një kabinet në mërgim. Por mund të mos jetë e lehtë të gjendet një vend që do ta lejonte atë të mbështeste rezistencën e armatosur nga jashtë Ukrainës.

Edhe Polonia dhe Lituania mund të kenë pak vullnet për ta pranuar qeverinë ukrainase, pasi kjo do të rriste në mënyrë dramatike kërcënimet ruse kundër tyre.

Garancitë e sigurisë së NATO-s nuk përfshijnë dispozita për mbështetjen e kryengritësve në vendet fqinje.

Nëse kësaj i shtohet antipatia e madhe e amerikanëve ndaj një lufte më të gjerë, për të mos përmendur admirimin e Donald Trump ndaj Putinit, atëherë rezultojnë se Zelensky do të hasë jo pak probleme. Por duke përmendur hapur qëllimet e tij, Putin ka arritur pa dashje të ringjallë NATO-n, një organizatë e cila deri vonë dukej e përgjumur.


Tani ka nisur koordinimi i masave nga ana e Perëndimit. Është ndaluar certifikimi i "NordStream II". Presidenti amerikan Joe Biden është angazhuar në një nivel diplomacie që mund të krahasohet vetëm me atë të administratës së George H.W. Bush në pragun të Luftës së Parë të Gjirit për të koordinuar aleatët e NATO-s.

Marrëveshja për sanksione gjithëpërfshirëse është në rendin e ditës në Evropë. Ndoshta ndryshimi më i dukshëm ka ardhur nga Gjermania, e cila ka qenë prej kohësh një ihtar e një

forme të Ostpolitikës me Rusinë, dhe ku marrëdhëniet e ngushta ekonomike supozohej se do të çonin në një zbutje të tensioneve. Pasoja ekonomike të sanksioneve për Amerikën dhe Evropën mund të jenë serioze. Çmimet e naftës së papërpunuar janë që tani mbi 100 dollarë për fuçi, dhe Gjermania sapo ka filluar të distancojë veten nga gazi natyror rus. Synimi i Putinit do të jetë të shohë se sa dhimbje mund të tolerojnë kundërshtarët e tij, dhe sa do të zgjasin sanksionet e ashpra përpara se Evropa të thërrasë në ndihmë SHBA-në.

Kryeministri britanik Boris Johnson ka deklaruar: "Nuk është e lehtë. Unë jam ish kryebashkiak i Londrës, dhe e di se sa e rëndësishme është që qyteti ynë të jetë i hapur për investime, ndaj situata është delikate".

Deri më tani, topi ka qenë në fushën e Putinit. Por tani që ai është angazhuar në një pushtim, Perëndimi ka filluar të kundërpërgjigjet. Po ashtu ka nisur edhe transformimi i Rosisë në sytë e Perëndimit nga kundërshtar në një armik. Pasoja e kësaj përballje do t'i japin formë politikës globale për dekadat e ardhshme.



**EURO GLASS**  
SAINT-DISAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Giresse: Është e qartë se në Kosovë të gjithë presin rezultate



**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Trajneri i ri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Alain Giresse, ka folur për medien franceze "Europe 1 Sport" lidhur me angazhimin e tij të ri në krye të "dardanëve". Ai ka theksuar se do të krijojë një ekip me lojtarë të rinj. "Këto janë rrethanat dhe këto janë mundësitë. Unë e njoh Kosovën. E kisha vizituar këtë shtet kur isha trajner i Senegalit. Kam kontaktuar me zyrtarë të futbollit atje. Rezulton se më kanë kontaktuar dhe kam dashur të jem në aksion, në aktivitet. U bë shpejt, thjesht, unë u regjistrova me Kosovën për dy vjet. Të gjithë presin rezultate, kjo është e qartë, por duhet të dini se

kjo kombëtare ekziston vetëm gjashtë vjet. Ne duhet të vazhdojmë të krijojmë një ekip, me lojtarë të rinj që kanë filluar të forcohen", ka thënë Giresse. Më tutje, trajneri francez ka shtuar se tash e pret Liga e Kombeve dhe ka kërkuar që të përparonin si ekip. "Është një punë ndërtimi dhe me Ligën e Kombeve që vjen (nga 2 qershor deri më 27 shtator), ne duhet të përparojmë. Unë kam qenë në vende të Afrikës dhe veçanërisht në Gabon (trajner midis 2006 dhe 2010), ku gjeta disi të njëjtat kushte. Ju duhet të ndërmerrni, përgatitni, strukturoni sportivisht një përzgjedhje", ka deklaruar trajneri i ri i Kosovës.

### SHKURT

#### FFK-ja organizon turneun 'Adem Jashari' në futsal

Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet komisionit për futsal gjatë kësaj jave do ta organizojë turneun tradicional "Adem Jashari". Sivjet në këtë turne, krahas Përfaqësueses së Kosovës, marrin pjesë edhe Kombëtarja e Shqipërisë dhe ajo e Maqedonisë së Veriut. Hapja e turneut bëhet më 2 mars në orën 18:50. Orari: Kosova-Maqedonia e Veriut (02.03.2022 - ora 19:00), Shqipëria-Maqedonia e Veriut (03.03.2022 - ora 19:00) dhe Kosova-Shqipëria (04.03.2022 - ora 19:00).

#### Gjykata e Tiranës pezullon nga detyra kreun e FShF-së, Armand Duka

Pas skandaleve të fundit dhe akuzave për manipulim të zgjedhjeve, Gjykata e Tiranës ka pezulluar të hënën Armand Dukën nga ushtrimi i detyrës së presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit. Por, ndryshe nga pesë vendimet e mëparshme të gjykatave, të cilat kanë qenë të karakterit civil, vendimi i sotëm është penal dhe Armand Duka rrezikon të ndiqet penalisht. Burime nga gjykata bëjnë me dije se janë pezulluar nga detyra edhe sekretari i përgjithshëm i FShF-së, Ilir Shulku dhe sekretari i përgjithshëm i Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, Ardian Haçin. Arsyeja lidhet me përgatitjet që Duka, Shulku dhe Haçi po bëjnë për organizimin e Asamblesë së 2 Marsit në kundërshtim të ligjit dhe pesë vendimeve të dhëna nga gjykata javën e kaluar.

#### Trajneri që e mposhti Realin në 'Bernabeu', i bashkohet ushtrisë ukrainase

Para pesë muaj më parë, ekipi i Sheriff mposhti Real Madridin midis "Santiago Bernabeu" me rezultat 1-2 në kuadër të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve. Trajneri i ekipit moldav ishte ukrainasi, Yuriy Vernydub. Ai tani i është bashkuar ushtrisë ukrainase në luftë kundër Rusisë, e cila po tenton ta pushtojë. Para katër ditëve, Vernydub e udhëhoqi skuadrën e tij në "play-off"-in e Evropa Ligës ndaj Bragas, kurse tani ka një detyrë krejt tjetër, ta mbrojë atdheun e tij. Sulmi ushtarak rus ndaj Ukrainës ka nisur të enjten.

#### Shearer: Broja ka të ardhme të ndritur

Armando Broja është tashmë një realitet i prekshëm në Premierë Ligë, një nga sulmuesit e rinj më në formë në ishull. Shifrat e tij të imponojnë respekt, ndërsa me lojën dhe klasën e shfaqur ka tërhequr vëmendjen e klubeve më të mëdha angleze. Së fundmi ylli kuqezi ka marrë edhe "bekimin" e legjendës angleze, Alan Shearer, golashënuesi më i mirë në historinë e Premierë Ligës. "Më lejoni t'ju them, ky djalë është klinik. Goli i tij kundër Brentfordit e bëri atë lojtarin më të ri në historinë e Premierë Ligës që shënon në secilin prej katër ndeshjeve të tij të para si titullar në shtëpi. Si sulmues, gjithçka ka të bëjë me marrjen e rasteve dhe shënimin e golave, kështu që statistikave si kjo më tregojnë se ai mund të lulëzojë në Premier Ligë. Ai gjithashtu shënon lloje të ndryshme golash. Broja është një sulmues i ri me sytë drejt golit dhe ka një të ardhme të ndritur në Premierë Ligë", u shpreh Alan Shearer për "BBC Sport".

## Veliu, 'ylli i javës' në Superligë

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. Për xhiron e 22-të në BKT Superligë është shpallur

futbollisti i KF Llapi, Valmir Veliu. "Sulmuesi anësor i llapjanëve ishte lojtari më i mirë i ndeshjes në fitoren bindëse që skuadra e tij e arriti në shtëpi ndaj Malishevës me rezultat 3:0. Ai shënoi dy gola në këtë ndeshje duke qenë më i merituari për fitoren e 11-të

të skuadrës së tij në këtë edicion", thuhet në njoftimin e FFK-së. Për Valmir Velium kjo është hera e dytë në këtë edicion që shpallet "ylli i javës", pasi këtë çmim e kishte fituar edhe në javën e 10 kur, po ashtu, kishte shënuar dy gola. Fitorja e kësaj jave ia ka mundësuar

KF Llapi që ta përforcojë pozitën e katërt në renditje në BKT Superligë me 39 pikë, duke e ruajtur hapin me skuadrat e kreut në garën për titull. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e KF Llapi, Valmir Veliu, e dha Ferat Klisurica, senior specialist në BKT.



## Yarmolenko dhuron 75 mijë funte për Ushtrinë e Ukrainës

LONDËR, 28 SHKURT - Sulmuesi i njohur ukrainas Andriy Yarmolenko raportohet se ka bërë një donacion të madh për Forcat e Armatosura të vendit të tij, pasi Ukraina po përballet me

luftë me Rusinë, ku rusët po tentojnë ta pushtojnë Ukrainën. 32-vjeçari është lojtari i tretë i vendit të tij me më së shumti paraqitje në histori të Kombëtarja e Ukrainës. Sipas

“Zorya Londonsk”, sulmuesi i West Ham Unitedit ka dhuruar 75 mijë funte për ushtrinë ukrainase. Vlen të theksohet se Yarmolenko është i lindur në Rusi, por prindërit janë

ukrainas, të cilët pastaj u rikthyen në vendlindje. Ish-sulmuesi i Dynamo Këvit dhe Borussia Dortmundit vlerësohet si një nga futbollistët më të mirë ukrainas, teksa është edhe



kapiteni i Kombëtares së këtij shteti.

## Humbasin lakersat, Sunsi dhe Golden State

NJU-JORK, 28 SHKURT - Phoenix Suns, skuadra më rekordin më të mirë sezonal, është mposhtur me rezultat 118-114 nga Utah Jazzi. Gjithsesi, Suns (Booker 30 pikë) ruan kreun e renditjes në Perëndim, ndërkohë që për Jazzin u dalluan Mitchell me 26 pikë e Clarkson me 22 pikë. Tjetër dështim për lakersat, që tashmë janë në krizë pas humbjes 123-95 ndaj New Orleansit në fushën e tij. LeBron Jamesi realizoi 32 pikë, por i vetëm e pati të pamundur të fitojë. Për miqtë, të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë. Humbje e papritur për Golden Staten, që u



mund me rezultat 107-101 në fushën e saj nga Dallasi, që rikuperoi një disavantazh prej 17-pikësh. Donqiq realizoi 34 pikë e 11 rebounde për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e 10 asistimet e Curryt për Warriorsin. Pas kohës shtesë fiton Detroiti, që mundi me

shifrat 127-126 Charlotten (Bey 28 pikë e Grant 26), ndërsa Philadelphia fitoi me lehtësi 125-109 ndaj New Yorkut. Embiid me 37 pikë e Hardeni me një “triple double” (29 pikë, 10 rebounde e 16 asistime) ishin protagonistët të fitores.

### REZULTATET

New York - Philadelphia	109-125
Phoenix - Utah Jazz	114-118
Indiana - Boston	128-107
Charlotte - Detroit	126-127
Houston - Clippers	98-99
Golden State - Dallas	101-107
Portland - Denver	92-124
Lakers - New Orleans	95-123

## Pioli para derbit me Interin: Duam t'i fitojmë të gjitha ndeshjet

MILANO, 28 SHKURT - Milani dhe Interi do të përballen mes vete sot (e martë), në kuadër të Kupës së Italisë. Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, fillimisht foli për kundërshtarin, duke thënë se nuk ka parashikime për një derbi të tillë. “Sezoni ka qenë i vështirë për të gjitha skuadrat, altermojnë momentet optimale dhe më pak optimale. Kampionati është shumë i balancuar, Milani dhe Interi janë ndër skuadrat më të forta. Nesër nuk ka parashikime sepse është derbi. Si gjithmonë kush do të mund të fitojë më shumë duela individuale do të ketë më shumë shanse për fitore”, ka thënë Pioli. 56-vjeçari deklaroi se dëshirojnë të fitojnë të gjitha ndeshjet deri në fund të këtij edicioni. “Ne duam t'i fitojmë të gjitha ndeshjet. Jemi të fokusuar në ndeshjen e nesërme, sepse po kujdesemi shumë”, u



shpreh trajneri italian Pioli. Ndeshja në mes të Milanit dhe Interit fillon në orën 21:00 dhe do të zhvillohet në stadiumin “Giuseppe Meazza”.

### SHKURT

#### Tenistja ruse, Anastasia Pavlyuchenkova, bën thirrje të ndalet lufta

Tenistja numër një e Rusisë, Anastasia Pavlyuchenkova, ka bërë thirrje për t'i dhënë fund dhunës dhe luftës ndaj popullit ukrainas. Në një shkrim të publikuar në “Instagram”, Pavlyuchenkova ka publikuar një shkrim, në të cilin u bënë thirrje autoriteteve ruse ta ndalojnë luftën. “Ambiciet personale apo motivet politike nuk mund ta justifikojnë dhunën. Kjo e merr të ardhmen jo vetëm nga ne, por edhe nga fëmijët tanë. Ndaloni dhunën, ndaloni luftën”, ka thënë fituesja e medaljes së artë në “Tokio 2020”. Të dielën Federata e Tenisit e Ukrainës i kërkoi organit drejtues të sportit, Federatës Ndërkombëtare të Tenisit (ITF) ta përjashtojë menjëherë Rusinë dhe Bjellorusinë nga organizimi dhe ta ndalojë Rusinë nga turnetë ekipore dhe individuale.

#### Xavi: Pedri është Iniesta i ri

Barcelona mposhti me shifrat 4-0 skuadrën e Atletico Bilbaos, në një sfidë ku skuadra e Xavi Hernandezit ka shkëlqyer. Pas ndeshjes tekniku spanjoll i katalanasve nuk ka nguruar ta krahasojë Pedrin me Andres Iniestën. “Në shumë gjëra ai më kujton Andresin”, ka thënë Xavi. Një lojë e mirë e zhvillua nga 19-vjeçari, konfirmohet edhe nga statistikat e “Opta”, ku dallohet qartë se “xhevahiri” i Barçës ka numrin më të lartë të pasimeve të sakta, 86. Nga këto 86 pasime, tetë ishin topa të gjatë, ndërsa dy ishin: një pas shpine dhe një tjetër në qendër të zonës. Topat e humbur prej tij ishin vetëm gjashtë. Krahas kësaj, me tri driblime ka barazuar Gavi dhe Adaman sa i përket këtij seksioni statistikor. Pedri ishte gjithashtu lojtari i dytë me më shumë rikuperime të topit. Vetëm Pique (13) kishte më shumë rikuperime të topit se Pedri (9).

#### Ibra: Nuk dorëzohem derisa të fitoj trofe me Milanin

Zlatan Ibrahimoviç vazhdon të jetë i lënduar, ndërsa vazhdon stërvitjen individuale që të kthehet sa më shpejt të stërvitet me grupin. Sulmuesi suedez vazhdon e shfaq probleme fizike, ndërsa është në pritjen e plotë të rikuperimit të tij. 40-vjeçari ka kontratë me Milanin deri në fund të këtij sezoni, ndërsa në një intervistë për “AS” suedezi është shprehur se e ardhmja e tij do të jetë futboll. “E ardhmja ime është futboll, bota ime është futboll. Më vjen keq që për momentin nuk mund të luaj. Kjo më jep shumë dhimbje, sidomos tani që skuadra po shkon mirë. Dua të jem atje dhe ta ndihmoj skuadrën. Që kur kam ardhur këtu, ne kemi bërë gjëra të mëdha dhe tani na mbetet vetëm një gjë, të fitojmë trofe. Ne po luftojmë dhe po punojmë për këtë, nuk dorëzohem derisa të fitoj me këtë ekip”, ka deklaruar Ibra.

## Verstappen: Red Bull i mirëbalancuar, gara e parë është testi i vërtetë

Pasi braktisi numrin 33, kampioni i botës në Formula 1, Max Verstappen, zbriti në pistën e Barcelonës për testet e para dimërore me numrin një në njëvendëshen e tij. Piloti i Red Bullit testoi makinën austriake

me shpresën që këtë sezon ta mbrojë titullin e fituar mes shumë polemikave tre muaj më parë. “Gjithçka funksionoi mirë gjatë këtyre provave dhe isha komod në makinë. Nuk më interesojnë kohët e dhëna gjatë këtyre testeve. Ato do t'i shoh

gjatë provave zyrtare në garën e parë. Makina është e balancuar mirë dhe bilanci i këtyre testeve të para është pozitiv”, u shpreh Max Verstappen, që dha kohën e katërt. “Mendoj se këto makina janë një hap përpara krahasuar me ato të

vjetrat, ndërkohë që mund të qëndrosh më pranë makinës që ke përpara. Vetëm në Bahrein, para garës së parë, kur edhe makina të jetë plot, do të shohim se si do të silltet makina. Gjithsesi, ndjesia e parë ishte pozitive”, ka thënë Verstappen.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA  
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85  
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 01.03.2022 rishpallë këtë:

### **KONKURS**

**Pozita: Menaxher i njësisë operative, me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashtë (6) muaj, vendi Deçan (1 pozitë), dhe Zyrtar i prokurimit me kontrate pune një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi, pune provuese gjashtë (6) muaj, vendi Pejë (1 pozitë).**

#### **Detyrat e punës për Menaxher të njësisë janë:**

- Menaxhon më njësinë operative, harton propozim planin vjetor të punës dhe kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e asetëve, përcjell realizimin e planit vjetor, është përgjegjës për disiplinën në punë dhe azhurnimin brenda njësisë.

#### **Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës:**

- Diploma universitare drejtimi ekonomik, bujqësisë ose juridik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve në vende të ngjashme të punës.

#### **Detyrat e punës për zyrtar të prokurimit janë:**

Përgatitë formularin në bazë të kërkesave nga njësitë e kërkesave për planifikim preliminar dhe përfundimtare të prokurimit, Në bazë të kërkesave të aprovuara nga KE inicion procedurat e prokurimit, varësisht nga vlera e tenderit bën përgatitjen e dokumenteve të ofertimit (ftesës për oferta, kërkesa për kuotime dhe kërkesa për propozime) dhe lëshimit të tyre, administrimin e tenderëve, monitorimin e procesit të prokurimit, përgatitjen e hapjes publike të ofertave dhe përpilimin e raporteve, si dhe punë tjera sipas ligjit të prokurimit.

#### **Kushtet për lidhjen e marrëdhënies së punës:**

Diplomë Universitare; fakulteti juridik, ekonomik ose fushë relevante

I Certifikuar për punë të prokurimit. Përvojë pune minimumi një (1) vjeçare.

#### **Procedura e aplikimit:**

Dokumentet dorëzohen në zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës së punës,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA  
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85  
www.krudriniibardhe.com

U skladu sa Uredbom o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji poslova i radnih zadataka, RKV "Drini i Bardhe" d d je dana 01.03.2022. godine ponovo objavila:

### **KONKURS**

Funkcija: Menadžer operative jedinice, sa ugovorom o radu od jedne (1) godine sa mogućnošću produženja, probni rad šest (6) meseci, mesto Dečane (1 pozicija), i službenik za nabavke sa ugovorom o radu od jedne (1) godine sa mogućnost produženja, probni rad šest (6) meseci, mesto Peć (1 pozicija).

#### **Zadaci rukovodioca jedinice su:**

- Rukovodi operativnom jedinicom, izrađuje godišnji plan rada i stara se o korišćenju i održavanju imovine, prati realizaciju godišnjeg plana, odgovoran je za radnu disciplinu i ažuriranje u okviru jedinice.

#### **Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:**

- fakultetsku diplomu ekonomije, poljoprivrede ili prava,
- Radno iskustvo od 3 godine na sličnim poslovima.

#### **Dužnosti službenika za nabavke su:**

Priprema obrazac na osnovu zahteva jedinica zahteva za preliminarno i konačno planiranje nabavki,

Na osnovu zahteva odobrenih od strane EK pokreće postupke nabavke, u zavisnosti od vrednosti tendera priprema tendersku dokumentaciju (poziv za podnošenje ponuda, zahtev za ponudu i zahtev za predloge) i njihovo izdavanje, administriranje tendera, praćenje nabavke, priprema javnog otvaranja ponuda i sastavljanje izveštaja, kao i drugi poslovi u skladu sa zakonom o nabavkama.

#### **Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:**

Fakultetska diploma; prava, ekonomije ili relevantne oblasti

Sertifikovan za poslove nabavke. Najmanje jedna (1) godina radnog iskustva.

#### **Aplikacija postupak:**

Dokumenti se dostavljaju u kancelariju br. 1 RKV "Drini i Bardhe" ulica "Mbretëresha Teute" br. 85 Peć.

Uz prijavu moraju biti priloženi sledeći dokumenti:

- CV (biografija),
- Kopija lične karte, dokaz o radnom iskustvu,
- I školska diploma za traženu stručnu spremu – kopija,

Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od šest (6) meseci.

Rok za podnošenje prijava je 15 dana od dana objavljivanja konkursa i završava se odgovarajućeg dana u 16:00 časova.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022 me nr. 2537 të datës 10.12.2021, Ndryshimit të Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022 me nr. 93 të datës 27.01.2022, nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 33 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; si dhe Vendimit të Auditorës të Përgjithshme me Nr. 364 të datës 25.02.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

## KONKURS

### për plotësimin e vendit të lirë të punës

<b>1. Pozita:</b>	<b>Zyrtar për dizajnim të raporteve dhe publikime</b>
<b>Numri i referencës:</b>	RZDRP/ZKA/06-02/22
<b>Grada:</b>	ZKA-B6
<b>Numri i pozitave:</b>	Një (1)
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimi i dizajneve dhe punëve të tjera grafike/vizuale për krijimin e identitetit, konceptit dhe përquarjes së mesazhit apo simbolikës së raporteve të auditimit sipas përmbajtjes së tyre.
- Përgatit të gjitha projektet e dizajnit, që nga konceptimi deri te shpërndarja;
- Përcakton imazhet, fontet dhe formatet duke përdorur softuerin e dizajnit grafik;
- Hulumton ide për të paraqitur koncepte dhe për të reklamuar produktet / shërbimet në rrjetet sociale, webfaqe, televizione, gazeta etj;
- Përdor teknikat e tipografisë;
- Krijon versione të ndryshme të dizajneve, logove, koncepte për broshura, prezantime, flyer-a, fletpalosje etj ;
- Asiston me realizimin dhe përgatitjen e videove dhe fotografive;
- Kryen edhe detyra të tjera, të ndërlidhura me dizajnin grafik dhe që paraqiten sipas nevojave dhe rasteve të caktuara.
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

#### Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti në fushën e dizajnit grafik ose të ngjashme;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha përkatëse.

#### Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 01.03.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 16.03.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu, br. 2537 datuma 10.12.2021 i Izmenu Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu br. 93 datuma 27.01.2022, članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 33 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 364 datuma 25.02.2022 Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

## KONKURS

### za popunjavanje slobodnih radnih mesta

<b>1. Položaj:</b>	<b>Službenik za dizajniranje izveštaja i publikacija</b>
<b>Broj reference:</b>	RZDRP/ZKA/06-02/22
<b>Nivo:</b>	ZKA-B6
<b>Broj radnih mesta:</b>	Jedno (1)
<b>Trajanje imenovanja:</b>	Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Izrada dizajna i drugih grafičkih/vizuelnih radova za kreiranje identiteta, koncepta i prenosa poruke ili simbolike revizorskih izveštaja prema njihovom sadržaju.
- Priprema projekte dizajna, od ideje do distribucije;
- Definiše slike, fontove i formate pomoću softvera za grafički dizajn;
- Istražuje ideje za predstavljanje koncepta i reklamiranje proizvoda/usluga na društvenim mrežama, veb stranicama, televiziji, novinama, itd.;
- Koristi tehnike tipografije;
- Kreira različite verzije dizajna, logotipa, koncepta za brošure, prezentacije, flajere, letke itd.;
- Pomaže u realizaciji i pripremi video zapisa i fotografija;
- Izvrši i druge zadatke, vezane za grafički dizajn i predstavljene prema specifičnim potrebama i slučajevima.
- Obavlja i druge zadatke po naređenju direktora departmana.

#### Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma u oblasti grafičkog dizajna ili slično;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna je sertifikacija iz relevantne oblasti

#### Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

#### Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i očekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

#### Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 01.03.2022.godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 16.03.2022.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

